Njoftim per konsultim publik
Këshilli i Bashkisë Maliq

Titulli: Marrja e rekomandimeve për propozimin "Për miratimin në parim për dhënien në përdroim të fondit pyjor, për ndërtimin e Kullave Eolike nga Kompania "WP MORAVA" shpk."
Propozuesi: Projekt akti eshte propozuar nga Ekzekutivi/Kryetari i Bashkisë, Z. Gëzim Topçiu
Sqarime për projekt aktin:
Bazuar në:Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Neni 64 "Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë", gërma "a";
* Ligji nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25;
* Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin Kullosor", i ndryshuar;
* Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike…", i ndryshuar;
* Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 299 datë 04.10.2022 "Për miratimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore të Bashkisë Maliq";
* Udhëzimi nr. 1, datë 09.06.2016 i Ministrit të Mjedisit "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", pika 22, gërma "j";
* Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor", shtojca 1, pika 8;
* Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467 datë 31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme", shtojca nr.3;
* Kërkesës së subjektit nr. 32 prot, datë 06.01.2026 dhe nr. 33 prot datë 06.01.2026;i propozohet Këshillit:
Miratimi në parim për dhënien në përdroim të fondit pyjor, për ndërtimin e Kullave Eolike nga Kompania "WP MORAVA" shpk."
Kalendari i konsultimit: Konsultimi publik do të realizohet si më poshtë:
Njesia Administrative Pojan, Fshati Plasë, fshati Zëmblak
Data : 25 maj 2026
Ora : 11:00, 12:00
Vendi: Qendra e fshatit Plasë, qendra e fshatit Zëmblak
Banorët do të kenë mundësi të konsultojnë në lidhje me propozimin e mesiperm.
Pjesëmarrës:
-Nga ana e Bashkisë dhe e Këshillit Bashkiak:Anëtarëte Këshillit Bashkiak, Përfaqësues nga ekzekutivi, Anëtarët e Komisionit te Ekonomisë dhe Financës, Komisionit te bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujerave, mbrojtjes se mjedisit, biodiversitetit të Këshillit të Bashkisë, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Administratori i NJA Pojan
-Nga komuniteti: Banorët e Bashkise Maliq, banorë dhe përfaqësues nga NJA Pojan, kryetarët e fshatrave, përfaqësues nga institucionet, përfaqësues nga biznesi, përfaqësues nga grupe të margjinalizuara, OJF, etj

-Forma e konsultimit:Takim publik
Qëllimi i këshillimit publik
Marrja e rekomandimeve për propozimin e ekzekutivit te cilin e gjeni ne linkun me poshte:
https://files.fm/u/3zkh9j2vs2
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit
Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:
1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;
2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit te Ekonomisë dhe Financës, Komisionit te bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujerave, mbrojtjes se mjedisit, biodiversitetit të Këshillit të Bashkisë
3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë;
4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt vendim
5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit;
6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre;
7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;
8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar;
9. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit
11/05/2026
Data e publikimit 11/05/2026